

1 E premte, 8 janar 2021

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit nuk janë të pranishëm]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita dhe mirëserdhët të
7 gjithë këtu në sallën e gjyqit dhe jashtë saj.

8 Sekretar i Gjykatës, ju lutem paraqisni rastin.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po, z. Gjykatës. Kjo
10 është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër
11 Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani i kërkoj palëve që të
13 prezantohen, duke filluar me Zyrën e Prokurorit të
14 Specializuar.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve. Në emër të
16 Prokurorisë sot paraqiten Alex Whiting, Zëvendësprokuror i
17 Specializuar; Valeria Bolici, prokurore; Line Pedersen,
18 menaxhere e rastit, e çështjes; edhe unë jam James Pace,
19 prokuror i asociuar.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

21 Tani Mbrojtja, të cilët po na ndjekin nga distanca. Unë do
22 t'i thërras emrat siç janë të reflektuar në emrin e çështjes
23 gjyqësore, duke filluar me avokatin e z. Gucati dhe pastaj me
24 të z. Haradinaj.

25 Z. Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë paraqitem
2 këtu në emër të z. Gucati. Unë ndihmohem nga bashkëmbrojtësi
3 Huw Bouden.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Toby Cadman.
5 Mirëdita, i nderuar gjykatës. Unë paraqitem në emër të z.
6 Haradinaj dhe ndihmohem nga Carl Buckley.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe për procesverbalin, unë
8 jam Gjykatësi i çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake të
9 çështjes.

10 Më 18 dhjetor, unë paraqita ose vendosa për caktimin e një
11 date për seancë sot: Së pari, për t'i lejuar z. Haradinaj që të
12 vetëdeklarohet; dhe së dyti, për të mbajtur një Konferencë për
13 Ecurinë e Çështjes në këtë rast.

14 Unë do të filloj me vetedeklarimin e z. Haradinaj. Por
15 përpara se të vazhdoj me rendin e ditën, unë do t'i kujtoj
16 palëve që në qoftë se duan të marrin fjalën dhe duan të
17 përgjigjen ndaj një çështje, ata duhen të ngrihen në këmbë në
18 qoftë se janë në sallën e gjyqit, ose të ngrenë dorën në qoftë
19 se po e ndjekin me videolidhje.

20 Në qoftë se dikush që po e ndjek këtë Konferencë për
21 Ecurinë e Çështjes do të ketë vështirësi teknike, ju lutem
22 informoni menjëherë Sekretarinë e Gjykatës ose mua duke bërë
23 shenjë me dorë, dhe ne do të bëjmë ç'është e mundur që në qoftë
24 se ndërpritet lidhja të rilidhemi menjëherë. Dhe në qoftë se
25 nuk mund të zgjidhet çështja menjëherë, atëherë mund të duhet

1 të bëjmë pak minuta pushim derisa të zgjidhet çështja e
2 lidhjes.

3 Atëherë, të fillojmë me çështjen e seancës për
4 vetëdeklarim.

5 Më 6 janar, pas kërkesës së avokatëve, unë miratova që z.
6 Haradinaj të mos ishte në pjesën e dytë të kësaj seance dhe të
7 merrte pjesë me videokonferencë për t'u vetëdeklaruar.

8 Në të njëjtën ditë, avokati i z. Haradinaj më informoi se
9 klienti i tij nuk pranoi të ishte i pranishëm për të vazhduar
10 me vetedeklarimin e tij.

11 Z. Cadman, përpara se të vazhdoj, a keni diçka për të
12 thënë?

13 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ne e kemi
14 paraqitur me shkrim sepse z. Haradinaj nuk ka pranuar të
15 paraqitet. Ai më ka thënë se nuk dëshiron të marrë pjesë mbi
16 bazën e protestës për mënyrën sesi është trajtuar, dhe që të
17 deklarohet në emër të tij një -- të bëhet një deklaram
18 pafajësie në emër të tij. Dhe ai më ka thënë mua që të marr
19 pjesë në këtë seancë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, e mora shënim
21 refuzimin e z. Haradinaj për t'u paraqitur, dhe unë them që
22 plotësohen kushtet sipas rregullës 68(4) të Rregullores..

23 Dhe në bazë të rregullës 92(2)(f), unë e konsideroj
24 refuzimin e z. Haradinaj për të marrë pjesë këtu si
25 mosvetëdeklarim të tij, dhe për këtë arsye unë do të bëj

1 deklaram pafajësie në emër të tij për të gjitha pikat e
2 Aktakuzës.

3 Me këtë mbyllet pjesa e parë e kësaj seance. Dhe do të
4 vazhdojmë me pjesën e dytë që ka të bëjë me ecurinë e çështjes.

5 Synimi im sot është që të shohim se ku jemi me përgatitjen
6 e çështjes dhe të organizohen shkëmbimet midis palëve. Në
7 veçanti, dëshiroj të diskutojmë gjendjen e hetimeve të
8 Prokurorit të Specializuar; sasinë e përafërt të provave dhe
9 dëshmive që do të sjellin palët në gjyq; dhe në lidhje me
10 çështjet që lidhen me dorëzim e materialeve, materialet
11 mbështetëse të Aktakuzës, materialet plotësuese, materialet
12 shfajësuese dhe materialet e mbrojtura; procedura për dorëzimin
13 e materialeve, sistemi i redaktimeve që do të ndërmerret; dhe
14 së fundi, ndonjë çështje tjetër që mund të ngrenë palët.

15 Unë e falënderoj Prokurorin e Specializuar edhe Mbrojtjen
16 për parashtrimet e tyre. Dëshiroj që t'i ftoj palët që të
17 paraqesin mendimet e tyre në mënyrë të përmbledhur për pikat në
18 rendin e ditës. Nuk ka nevojë që secila palë t'i përsërisë ato
19 që ka dorëzuar me shkrim.

20 I kujtoj palëve që të njoftojnë paraprakisht, në qoftë se
21 parashtrimet e tyre kërkojnë nxjerrjen e informacioneve
22 konfidenciale në mënyrë që të hyjmë në seancë private.

23 Të kalojmë te pyetjet e përgjithshme.

24 Përpara sesa t'u jap fjalën palëve, dua t'i kujtoj ata për
25 parimet kryesore të përgjithshme të nxjerrjes së materialeve në

1 kuadrin e Dhomave të Specializuara.

2 Nxjerrja e materialeve është një proces *inter partes* në
3 formë elektronike të organizuar dhe lehtësohet përmes sistemit
4 të menaxhimit të gjykatës. Nxjerrja është prioritet për
5 Prokurorinë në këtë fazë, dhe palët do të nxjerrin dokumentet
6 apo provat që kanë rëndësi thelbësore dhe të vërtetë për
7 çështjen dhe jo volumin më të madh të provave.

8 Dhe duke pasur parasysh parimin e seancave publike, provat
9 regjistrohen si publike përveçse nëse ka arsye për t'i
10 klasifikuar ato më ndryshe. Pala që bën nxjerrjen e materialeve
11 vendos se çfarë niveli klasifikimi do t'i japë.

12 Unë ftoj tani Prokurorinë që të na flasë për pikën e parë
13 në rendin e ditës. Pra, ku është me hetimet; sasinë e provave
14 që ka ndërmend të përdorë në procedura; dhe sa dëshmitarë
15 dëshiron të thërrasë.

16 Z. Pace.

17 Z. PACE: [Përkthim] Unë nuk kam ndonjë gjë të madhe për
18 t'i shtuar atyre që kemi dorëzuar me shkrim, por do të bëj një
19 përmbledhje të shkurtër.

20 Siç e kemi thënë edhe në parashtrimet tona me shkrim,
21 hetimet janë në vijimësi. Ne kemi propozuar një afat për
22 nxjerrjen e materialeve dhe në atë kohë ne do të kemi
23 përgatitur edhe -- do të kemi bërë edhe hetimet më kryesore, me
24 kushtin që sigurisht ato hetime mund të vazhdojnë edhe gjatë
25 procesit. Dhe gjatë kësaj ato -- do të bëhen edhe aplikimet

1 përkatëse për nxjerrjen e materialeve.

2 Përveç sasinë së provave që do të jepen, do të paraqiten
3 në gjykim, ne kemi thënë që kemi 114 zëra në listën tonë.
4 Presim që kjo do të jetë pjesa kryesore e provave. Po kështu,
5 këtë javë ne kemi dorëzuar edhe dokumente që janë sipas
6 rregullës 103, dhe sidomos ato që kanë të bëjnë me provat
7 shfajësuese. Pra, këto janë 67 që kanë qenë në këtë paketë; dhe
8 këto janë pika të nxjerra që janë 119 dokumente.

9 Për sa i përket listës së dëshmitarëve, janë -- lista
10 është po ajo që kemi paraqitur në parashtrimin me shkrim, që
11 janë 10 dëshmitarë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

13 Tani t'i kalohem Mbrojtjes për të thënë mendimet e tyre
14 për atë që tha Prokuroria dhe për pikat e tjera në pyetjet e
15 përgjithshme.

16 E kam parë që Mbrojtja e z. Haradinaj ka thënë që ka
17 nevojë për një ose dy muaj për hetime, kurse Mbrojtja e z.
18 Gucati nuk është në gjendje të thotë në këtë moment sesa kohë
19 do t'i duhet për hetime. Unë kam parë në parashtrimet me shkrim
20 që asnjëri prej mbrojtësve nuk dëshiron të japë njoftim për
21 alibi, apo ndonjë arsye për parashtrime që kanë të bëjnë me
22 përjashtimin e përgjegjësisë penale.

23 Z. Rees.

24 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë nuk kam
25 ndonjë gjë për të shtuar ndaj atyre që kam dhënë me shkrim.

1 Dua ama që Zyra e Prokurorit të Specializuar të pranojë
2 çështjet që kemi paraqitur ne në parashtrimet me shkrim në
3 lidhje me dorëzimin e dokumentacionit, që janë përshkruar në
4 vendimin tuaj të konfirmimit, që janë përmendur si paketa 1,
5 paketa 2, paketa 3, apo që në aktakuzë përmenden si dorëzimi i
6 parë, dorëzimi i dytë, dorëzimi i tretë, të cilat së bashku
7 janë klasifikuar ose janë quajtur si informacion konfidencial.
8 Në qoftë se Prokuroria mund të na thotë sot kur do t'i marrim
9 këto materiale dhe një kohë të përafërt -- një llogaritje të
10 përafërt sesa material ka aty?

11 Pasi ta kemi atë material, ne do të jemi në gjendje që të
12 ndihmojmë më shumë Gjykatën në lidhje me sa kohë do të duhet
13 për përgatitjet e mbrojtjes dhe aspekte të tjera.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

15 Z. Cadman.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë mbështes
17 të njëjtën gjë që tha kolegu. Ne kemi thënë se do të na duhet
18 afërsisht një ose dy muaj, por kjo është e bazuar mbi situatën
19 siç është tani. Ne sigurisht duhet të shqyrtojmë pozicionin
20 tonë nën dritën e materialeve shtesë që ka ndërmend të na i
21 japë Prokuroria deri më 19 shkurt. Pra, një ose dy muaj është
22 thjesht një llogaritje e përafërt tani duke pasur parasysh se
23 ne nuk -- kemi shumë të panjohura ende.

24 Desha të përsëris atë që tha z. Rees, që për sa i përket
25 paketave 1, 2 dhe 3, edhe avokati i z. Haradinaj edhe ai i z.

1 Gucati kanë kërkuar sqarime në lidhje me kohën se kur do të
2 dorëzohen këto materiale. Dhe unë, pra, thjesht po përsëris atë
3 që tha z. Rees dhe nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar në
4 këtë fazë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

6 Z. Prokuror, dëshironi t'i përgjigjeni kësaj pyetje tani,
7 apo t'i kalojmë të gjitha kategoritë një nga një? Ndoshta mund
8 të bëjmë një diskutim për të tani meqë u ngrit kjo çështje nga
9 Mbrojtja.

10 Z. PACE: [Përkthim] Së pari do t'i përgjigjem

11 parashtrimeve të zotit -- të Mbrojtjes së z. Haradinaj, në
12 lidhje me një ose dy muaj kohë që i duhet për hetime.

13 Siç e dini, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka thënë që
14 nuk ka asnjë arsye pse mos të fillojë gjyqi në fillim të
15 pranverës të këtij viti, dhe z. Haradinaj ka thënë -- mbrojtësi
16 i tij ka thënë që është më e përshtatshme mesi -- ose fillimi i
17 verës ose mesi i verës.

18 Megjithatë, siç e thashë më herët, pjesa më e madhe e
19 materialeve të cilat do të mbështetemi në gjykim tanimë i
20 është dhënë atyre. Mbrojtja e ka ditur se për çfarë është kjo
21 çështje që nga koha kur janë arrestuar të akuzuarit, që në
22 shtator, dhe aktakuza u konfirmua në dhjetor. Pra, kur flasim
23 për afatet kohore të hetimeve të Mbrojtjes, ne themi që ata
24 duhet të kishin filluar me këto hetime dhe duhet të ishin në
25 vazhdimësi. Dhe nuk mendojmë që duhen disa javë apo disa muaj

1 pas afatit të dorëzimit të materialeve për të bërë ata hetimet
2 e tyre, duke pas parasysh që pjesa më e madhe e materialeve
3 është dorëzuar.

4 Tani, në lidhje me këto tri paketat e materialeve. Ne të
5 gjithë sa jemi këtu e dimë se për çfarë bëhet fjalë në këto
6 materiale. Mbrojtja pret nga Zyra e Prokurorit të Specializuar,
7 pret, si të thuash, që Prokuroria t'i japë armët në dorë për të
8 luftuar -- që të akuzuarit kanë përdorur për të kryer krimet e
9 tyre. Duke bërë -- po të bënim këtë, kjo do të ishte në
10 kundërshtim me parimin e procedurave që ka ngritur Zyra e
11 Prokurorit të Specializuar.

12 Unë vë në dukje se që në 24 dhjetor 2020, në dy vendime
13 tuajat, i nderuar Gjykatës, ju keni thënë që vendimi për
14 mbajtjen e tyre në paraburgim duhet të vazhdojë sepse ata mund
15 të kryejnë krime të ndryshme përmes kërcënimit, frikësimit të
16 dëshmitarëve potencialë. Dhe unë gjithashtu them që Zyra e
17 Prokurorit të Specializuar ka dhënë deklaratën e një hetuesi që
18 ka të bëjë me këto tri paketa që po i diskutojmë si pjesë e
19 aktakuzës.

20 Pra, Zyra e Prokurorit të Specializuar vazhdon t'i
21 rishikojë këto materiale, duke përfshirë edhe këto tri paketa,
22 nën dritën e detyrimeve të veta, por ZPS-ja nuk ka ndërmend që
23 t'i japë të akuzuarve dokumente që nuk përmbajnë materiale
24 publike. ZPS-ja sigurisht do të bëjë aplikimet apo kërkesat në
25 lidhje me këtë duke pas parasysh dispozitat sipas ligjit dhe

1 Rregullores, dhe këtë do ta bëjë para përfundimit të afatit të
2 dorëzimit të materialeve.

3 Për sa i përket sasisë së materialeve që përmbahen në këto
4 tri paketa, unë mund t'i referoj ata te deklarata që përmenda,
5 që është një deklaratë e një hetuesi që është dorëzuar të
6 hënën, dhe aty i keni materialet mbështetëse dhe në atë
7 dokument keni edhe numrin e faqeve për secilën prej këtyre
8 paketave.

9 Nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar në këtë moment.
10 Jam i hapur për ndonjë pyetje.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

12 Nëse ka materiale shfajësuese në këto paketa, a do të
13 dorëzohen ato në bazë të rregullës 103?

14 Z. PACE: [Përkthim] Sigurisht ne po i shqyrtojmë këto në
15 vijimësi, dhe për momentin vlerësimi jonë si Zyrë e Prokurorit
16 të Specializuar është që këto tri paketa përfshihen nën
17 rregullën 102 dhe jo rregullën 103, dhe janë disa dispozita të
18 ligjit të cilat zbatohen në këto raste. I referohem p.sh.,
19 rregullës 106 dhe nenit 21(6).

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Rees, keni për të thënë ndonjë gjë?

22 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Sigurisht janë
23 shumë materiale, shumë informacione, dhe do të na duhet një
24 farë kohe për t'i përtypur e për të parë se cili është
25 pozicioni i saktë i Prokurorisë. Por në qoftë se do të marrim

1 ndonjë sqarim me shkrim nga ZPS-ja në lidhje me këto materiale,
2 çfarë materialesh do të na jepen, do të na bëhen të ditura, te
3 cilat do të mbështeten? Çfarë materialesh do të identifikojnë
4 për dorëzim, mbi bazën e rregullës 102 dhe 103, apo cilat pjesë
5 të tyre ata nuk dua të na i japin fare? Kur do t'i marrim këto
6 sqarime me shkrim nga Prokuroria?

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

8 Z. Cadman, keni ndonjë gjë për të shtuar?

9 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, patjetër.

10 Unë do të pres për Prokurorinë që t'i përgjigjet asaj që kërkoi
11 z. Rees. Ne si kërkesë kemi të njëjtën kërkesë si ai. Unë duhet
12 të shpreh një lloj shqetësimi se ne pritët që të shkojmë në
13 gjykim për çështje që janë kaq thelbësore dhe të cilat nuk do
14 të na bëhen të ditura. Nuk e shikoj sesi dy të pandehurit -- dy
15 të pandehurve do t'i jepet mundësia për një gjykim të drejtë në
16 këto rrethana.

17 Pika tjetër që desha të ngre është, që sugjerimi që
18 hetimet duhet të kishin filluar nga Mbrojtja që në shtator apo
19 në dhjetor të vitit të kaluar, nuk kanë lidhje fare, janë krejt
20 të papërshtatshme. Sepse ne në qoftë se shikojmë këto
21 materialet që janë dorëzuar kohët e fundit, dhe fakti që pjesa
22 më e madhe e materialit nuk do të jepet deri më 19 shkurt, si
23 mund të kishim filluar ne hetimet kur këto materiale nuk na
24 janë bërë të ditura? Pra, nuk e shikoj se çfarë argumenti ka
25 Prokuroria këtu, po bën Prokuroria këtu.

1 Dhe pika e fundit është; Prokuroria thotë që ende po
2 vazhdon me intervistat e dëshmitarëve, dhe kjo përbën një lloj
3 shqetësimi për sa i përket gatishmërisë së Prokurorisë për ta
4 dorëzuar argumentin dhe pozicionin e saj. Unë them që duhet të
5 kemi një lloj sqarimi, të kemi afate të qarta se kur ka ndërmend
6 Prokuroria që ta paraqesë dosjen e saj. Nuk mund të presim ne
7 të fillojmë me hetimet tona në qoftë se nuk e dimë se çfarë
8 çështje është ngritur kundër nesh.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

10 Z. Prokuror, a mund t'i përgjigjeni pyetjes së z. Rees sa
11 i takon kohës?

12 Z. PACE: [Përkthim] Do të filloj duke thënë se asnjë afat
13 nuk është vendosur nga Gjykatësi sa i takon dhënies së
14 informacion -- nxjerrjes së materialeve. Ne propozojmë një afat
15 që është 19 shkurti, që është një afat shumë i hershëm
16 faktikisht. Prokuroria do të bëjë çmos që të ndihmojë për të
17 ecur me proceset kjo çështje.

18 Sa i takon tri paketave, bie pikërisht në objektin e
19 nxjerrjes së materialeve, por duhet që të jemi në gjendje që të
20 depozitojmë aplikimet tona të nevojshme sa i takon tri
21 paketave, brenda 15 ditëve.

22 Nuk e di nëse, i nderuar z. Gjykatës, dëshironi që t'i
23 përgjigjem dhe pyetjes apo çështjeve të tjera të ngritura nga
24 avokati?

25 Sa i takon gjykimit të drejtë dhe të rregullt, do të

1 thosha që ne si Prokurori mendojmë se nxjerrja e tri paketave
2 nuk ka ndikim në rregullsinë dhe drejtësinë e këtij procesi.
3 Pikë së pari, materialet mbështetëse të aktakuzës që ne i kemi
4 vënë në dispozicion, ku përshkruhet përmbajtja e tri paketave,
5 është diçka në të cilën mund të mbështetem.

6 Pra, aktakuza kundër të akuzuarve është konfirmuar pa
7 depozitim të këtyre tri paketave si prova. Pra, ka një listë
8 që i është bashkëngjitur aktakuzës, e cila tani mund t'i vihet
9 në dispozicion Mbrojtjes. Por për të qenë të qartë, nëse ju si
10 Gjykatës, nëse jeni dakord me Prokurorinë që këto tri paketa
11 për aq kohë sa nuk përmbajnë, pra, informacion publik, nuk
12 është e nevojshme që t'i vihen në dispozicion Mbrojtjes. Kjo
13 nuk do t'i pengonte të drejtat e të akuzuarve për gjykim të
14 rregullt dhe të drejtë.

15 Për të sqaruar më tej lidhur me këtë -- me çështjet e
16 ngritura nga ekipi i Mbrojtjes, do të thosha sa i takon
17 intervistave që u përmendën aty, janë te grupi pikërisht i --
18 është pjesë e zotimeve që janë ndërmarrë tashmë.

19 Avokatët e Mbrojtjes e kanë ngritur përsëri çështjen se
20 kur mund të pritët të fillojnë hetimet e tyre, por unë mendoj
21 që pjesa më e madhe e materialeve të cilat ne do t'i përdorim
22 si bazë, janë nxjerrë tashmë, janë vënë në dispozicion. Akuzat
23 janë të qarta. Kështu që ata i kanë të gjitha mundësitë si
24 Mbrojtje të fillojnë hetimin e tyre. Sigurisht, nëse ne do t'i
25 nxjerrim materiale të tjera Mbrojtjes, sigurisht që ata do të

1 kenë të nevojshme hetime të tjera. Por sa i takon fillimit të
2 procesit të hetimeve nga ana e tyre, Prokuroria nuk e kupton
3 përse Mbrojtja nuk ka filluar tashmë.

4 Faleminderit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

6 Z. Rees, ju lutem.

7 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë shpresoj që
8 ZPS-ja është në dijeni të parashtrimeve tona të bëra me shkrim,
9 që ne i kërkojmë Prokurorisë që të japë prova sa i takon
10 dokumentacionit që përmbajnë paketat 1, 2 dhe 3, siç përmendëm
11 më përpara, pra, që ato janë të vërteta dhe që vërtet përmbajnë
12 informacion të mbrojtur.

13 Ne gjithashtu i kemi kërkuar Prokurorisë që pamjet filmike
14 të sekuestruara të personit apo personave që e kanë nxjerrë
15 këtë dokumentacion, ia kanë vënë, pra, në dispozicion Shoqatës
16 së Veteranëve të Luftës të UÇK-së, të na e japin edhe neve.

17 Z. Pace, nëse mund të na konfirmojë që do ta bëjë këtë
18 gjë, dhe nëse po me ç'afat?

19 Ne, gjithashtu, kemi ngritur në parashtrimet tona faktin
20 se aktakuza përmend "bashkëpunëtorë", apo "persona të tjerë të
21 caktuar" apo "persona të tjerë", të cilët pretendohet se kanë
22 marrë pjesë në veprat penale të kryera lidhur me nxjerrjen e
23 këtij materiali, pra, vënien në dispozicion të këtij materiali
24 Shoqatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së. Edhe në këtë rast i
25 lutemi Zyrës së Prokurorit që të na identifikojë këta persona,

1 nëse mundet, në mënyrë që ne të fillojmë përgatitjet tona.

2 Kemi të drejtë të njohim natyrën e plotë dhe shkakun e
3 akuzave të ngritura kundër z. Gucati. Pa na u bërë kjo gjë, nuk
4 fillojmë dot me përgatitjet.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

6 Z. Cadman, mund të shtoni diçka?

7 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Z. Gjykatës,
8 thjesht do të doja vetëm të ritheksoja atë që është thënë
9 tashmë. Pra, që e kemi thënë në parashtrimet tona me shkrim,
10 por edhe atë që tha parafolësi im, z. Rees. Unë nuk mendoj se
11 ne mund të fillojmë pa na u sqaruar plotësisht, apo në një
12 shkallë të mjaftueshme gjërat nga Prokuroria.

13 Dua të ritheksoj shqetësimin tim, siç e përmendi edhe z.
14 Rees, që ne nuk mund të fillojmë hetimet tona në bazë të
15 materialeve që nuk i kemi në dispozicion.

16 Prokuroria nuk i është përgjigjur fare çështjes apo
17 pyetjes që ngremë ne. Materiali që na kanë vënë në dispozicion
18 nuk mund të na ndihmojë për të konstatuar nëse ka apo jo
19 informacion të mbrojtur, që është dhe thelbi i kësaj çështje.

20 Unë nuk e di sesi Prokuroria mban këtë qëndrim. Z.
21 Gjykatës, duhet të sigurohemi që të ketë qartësi nga -- sa i
22 takon qëndrimin të Prokurorisë përpara se ne të fillojmë me
23 punën tonë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

25 Z. Prokuror, një përgjigje të fundit sa i takon kësaj

1 çështjeje.

2 Z. PACE: [Përkthim] Unë do t'i marr me radhë, duke filluar
3 nga e para. Përgjigjem duke thënë se Prokuroria do të përmbushë
4 barrën që i takon, detyrimin që i takon, që do të konstatojnë
5 se dokumentet, pra, kanë përmbajtur apo jo informacion
6 konfidencial dhe jopublik.

7 Sa i takon pamjeve filmike të marra nga sistemi i kamerave
8 të sigurisë, procesi i nxjerrjes së materialeve është duke u
9 kryer, pra, është në proces e sipër, prandaj dhe kjo do të
10 bëhet përpara afateve të vendosura.

11 Sa i takon parashtrimeve të bëra me shkrim nga ekipi i
12 Mbrojtjes të z. Gucati, por edhe ato që u thanë sot në formë
13 verbale, do të thosha se për aq sa Mbrojtja e z. Gucati e
14 zbraps formën e aktakuzës, e cila sipas parashtrimeve tona, ka
15 të bëjë me "bashkëpunëtorë" apo "persona të tjerë", sipas
16 rregullës 67 [siç u përkthye], janë disa parashtrime me shkrim
17 të cilat ZPS-ja do t'u përgjigjet, pra, këtyre zbrapsjeve.

18 Unë do të thosha që sa i takon sqarimit të bërë në këto
19 parashtrime, kjo bie ndesh me -- kjo ka të bëjë pikërisht me
20 parashtrimet e bëra me shkrim dhe me gojë këtu. Unë do të
21 thosha se këto reflektojnë akuza të cilat janë ngritur kundër
22 të akuzuarve dhe jo kundër personave të tjerë.

23 Sa i takon pikave të ngritura, sa i takon nxjerrjes së
24 paketave, unë mendoj se e kam shteruar këtë çështje. Ne do të
25 bëjmë parashtrime me shkrim sipas nevojës. Edhe njëherë

1 dëshiroj që të ritheksoj se provat kryesore në të cilat
2 mbështetet kjo çështje, janë vënë në dispozicion tani. Këto
3 krime janë të regjistruara me pamje dhe me zë, kështu që mendoj
4 se Mbrojtja është në gjendje që të fillojë hetimin.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

6 Nuk e di nëse dikush nga ju dëshiron që t'u përgjigjet
7 këtyre, apo dëshironi të bëni parashtime të tjera? Jo.

8 Po. Z. Rees, ju lutem.

9 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ne e kemi
10 përmendur faktin që aktakuza përmend "bashkëpunëtorë", "persona
11 të tjerë të caktuar" dhe "persona të tjerë", dhe ne kemi parë
12 që në vendimin tuaj sa i takon konfirmimit të aktakuzës, ju si
13 Gjykatës e keni bërë të qartë se ZPS-ja akuzonte edhe disa
14 anëtarë të shtypit, pra, si të thuash, punonjës të shtypit të
15 mediave të ndryshme.

16 Ajo që unë dua të bëj si pyetje tani, apo dua të kërkoj,
17 është që të na bëhen të ditura këto, pra, informacione të
18 mëtutjeshme lidhur me këto, në mënyrë që ne të kuptojmë natyrën
19 e plotë të çështjes së ngritur kundër nesh. Dua ta bëj të qartë
20 që, siç e kemi thënë në parashtimet tona me shkrim, ne si
21 Mbrojtje e z. Gucati, refuzojmë që këto sulme që bën ZPS-ja
22 kundër mediave dhe personave të tjerë në Kosovë, duhen -- pra,
23 janë -- i refuzojmë ato, i zbrapsim, dhe i kërkojmë ZPS-së që
24 ta bëjë të qartë se çfarë nënkupton, çfarë pretendon me
25 përmendjen e këtyre personave të ndryshëm, në mënyrë që edhe ne

1 të jemi në gjendje që të përgjigjemi siç duhet.

2 Ne ende nuk jemi në gjendje të kuptojmë qartësisht dhe
3 plotësisht natyrën dhe shkakun e akuzave të ngritura kundër të
4 akuzuarve.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

6 Z. Prokuror, për herë të fundit, pra, një ndërhyrje të
7 fundit për këtë temë në mënyrë që të vijojmë me rendin e ditës,
8 ju lutem.

9 Z. PACE: [Përkthim] Po. Unë -- ajo që mund të them është
10 thjesht që të ritheksoj se, sa i takon parashtrimeve të
11 Mbrojtjes se kush mund të jenë këta bashkëpunëtorë, unë mendoj
12 se kjo mund të bëhet me shkrim, pra, në mocionet paraprahe.

13 Sa i takon përmendjes së parashtrimeve me shkrim, ku
14 Mbrojtja në mënyrë të përsëritur përmend sulmin që ZPS-ja u ka
15 bërë mediave, unë jam shprehur tashmë. Ne si Prokurori ngremë
16 akuza vetëm ndaj të akuzuarve.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

18 Kalojmë tani në pikën tjetër të agjendës që është -- që
19 janë materialet mbështetëse ndaj aktakuzës.

20 Unë kam parë, kam lexuar, pra, se ZPS-ja i ka nxjerrë të
21 gjitha materialet mbështetëse të aktakuzës Mbrojtjes më ka 4
22 janar 2021, së bashku me përkthimet në gjuhën shqipe. Unë i
23 kërkoj ZPS-së që të japë -- të shprehet sa i takon nxjerrjes së
24 materialeve të tjera mbështetëse të aktakuzës, që më saktë janë
25 ato që janë materiale provuese dhe hollësi të tjera.

1 Z. Prokuror, fjala për ju.

2 Z. PACE: [Përkthim] Sa i takon nxjerrjes së materialeve
3 mbështetëse të aktakuzës, ne e kemi përbushur këtë tashmë të
4 hënën e kësaj jave. Janë 401 pika -- 114 pika apo artikuj të
5 ndryshëm. Nuk kam të shtoj më lidhur me këtë.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kam një pyetje. A mund të
7 konfirmoni që përskrimi i hollësishëm nuk ka nevojë për
8 redaktime dhe nëse mund të klasifikohet, apo nëse ka nevojë për
9 klasifikim më saktë?

10 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar z. Gjykatës. Unë e vë re
11 se na është kërkuar që të japim parashtrimet tona për masat
12 mbrojtëse. Besoj se ishte brenda datës 6 janar. Ne i kemi -- ne
13 nuk kemi bërë parashtrime të tilla siç parashikohej edhe nga
14 depozitimi që kemi bërë neve i protokolluar në datë 4 janar,
15 sepse aneksi prej aktakuzës përmban një tabelë analitike që
16 mund t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes. Pra, ne nuk kemi
17 kundërshtim që kjo të bëhet publike në mënyrë të menjëhershme.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

19 Tani ia jap fjalën Mbrojtjes për materialet mbështetëse
20 për aktakuzën.

21 Z. Rees, keni diçka për të thënë?

22 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kemi asgjë
23 për të shtuar sa i takon -- nga ato që kemi bërë në
24 parashtrimet me shkrim.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

1 Z. Cadman.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit i
3 nderuar z. Gjykatës. Ne tashmë ia kemi bërë të ditur ZPS-së,
4 pra, që kemi pasur mundësi që të marrim këto materiale dhe do
5 të hartojmë një tabelë.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

7 Tani i kthehem pikës tjetër në rendin e ditës.

8 Unë kam mësuar se ZPS-ja është e gatshme që të nxjerrë
9 materiale të tjera, sipas rregullës 102(1)(b), brenda datës 19
10 shkurt 2021, ose jo më vonë se 30 ditë përpara hapjes së
11 procesit gjyqësor nga ana e Prokurorisë, në varësi të masave të
12 tjera që mund të miratohen.

13 Tani dëshiroj që t'ia fjalën ZPS-së të na -- që të
14 shprehet lidhur me sasinë e përafërt dhe llojin e materialeve,
15 redaktimet nëse janë të nevojshme, dhe hollësi të tjera që
16 dëshiron të vendosë në dispozicion ZPS-ja.

17 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam se çfarë të shtoj sa u takon -
18 - nuk kam ç't'i shtoj parashtrimeve tona. Në parashtrimet me
19 shkrim, ne kemi theksuar, pra, se ne mund të nxjerrim materiale
20 të ngjashme. Intervistat mund të nxjerrin deklaratatë të tjera të
21 dëshmitarëve, por sa i takon he për he, kjo është nxjerrë --
22 ato materiale që janë nxjerrë deri tani nuk kanë nevojë për
23 redaktime.

24 Mund t'ju jap një ide të përafërt se kjo do të varet nga
25 veprimet, apo veprimet e pretenduara të të akuzuarit. Pra,

1 materialet që ne i kemi nxjerrë deri tani e mbulojnë si të
2 thuash pjesën më të madhe të materialeve mbi të cilat
3 Prokuroria e ka mbështetur, pra, akuzën e vetë ndaj sjelljes së
4 të akuzuarit. Pra, pjesa më e madhe e këtyre materialeve i
5 është nxjerrë tashmë Mbrojtjes.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Ia jap fjalën Mbrojtjes.

8 Z. Rees.

9 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Sa i takon
10 parashtrimeve me shkrim apo krahas parashtrimeve me shkrim, dua
11 të theksoj se nuk e kemi të qartë nëse Prokuroria propozon që
12 brenda datës 19 shkurt të na nxjerrë materiale në bazë të
13 analizës që u ka bërë artikujve elektronikë. Nëse është kështu,
14 atëherë s'kam çfarë të shtoj.

15 Por nëse Prokuroria sugjeron se materialet do të jenë
16 rezultat i analizës së materialeve elektronike të sekuestruar,
17 që përmendi në paragrafin 10 të parashtrimit, atëherë ky përbën
18 përjashtim nga -- dhe nëse ky është i përjashtuar nga propozimi
19 i datës 19 shkurt, unë mendoj se duhet të vendoset një afat
20 edhe për këtë. Pra, një datë brenda të cilës do të na jepet e
21 plotë analiza që i ka bërë Prokuroria artikujve të sekuestruar
22 elektronikë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. Cadman.

25 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit i

1 nderuar z. Gjykatës.

2 Desha që të ritheksoj pikën, siç e kemi në parashtrimet
3 tona me shkrim, që ne nuk e konsiderojmë afatin 30-ditor
4 përpara hapjes së procesit gjyqësor nga ana e Prokurorisë që
5 është i mjaftueshëm. Pra, mendojmë se ky afat nuk është i
6 mjaftueshëm. Do t'i luteshim Prokurorisë që të na i vendosë në
7 dispozicion menjëherë këto materiale, pra, më përpara se ky
8 afat.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Prokuror, mund t'u përgjigjeni këtyre çështjeve?

11 Z. PACE: [Përkthim] Në fillim avokati i z. Gucati. Unë e
12 konfirmoj se këtë afat të vendosur vetë nga ana jonë, që është
13 data 19 shkurt, brenda këtij afati ne synojmë që të nxjerrim
14 dhe materialet e lidhura me artikujt e sekuestruar. Nëse kjo
15 nuk do të jetë realiste, unë do ta informoj z. Gjykatës lidhur
16 me këtë problem.

17 Sa i takon afatit 30-ditor përpara fillimit të procesit
18 gjyqësor, çështje e ngritur nga avokati i z. Haradinaj, ne kemi
19 parashtruar tashmë me shkrim se data 19 shkurt do të jetë pranë
20 fillimit të procesit gjyqësor. Unë mendoj se është shumë herët
21 të themi tani se afati 30-ditor nuk është i mjaftueshëm sa i
22 takon nxjerrjes së materialeve, sepse materialet janë ende duke
23 u nxjerrë.

24 Pra, ne mund t'i rikthehemi çështjes së afatit 30-ditor,
25 nëse është i mjaftueshëm apo jo, kur të vijë momenti i duhur.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

2 Kalojmë tani te pika tjetër në rendin e ditës që ka të
3 bëjë me materialet, me provat -- materialin provues për
4 përgatitjen e Mbrojtjes, që janë sipas rregullës 102(3).

5 Dëshiroj që t'i rikujtoj ZPS-së që nxjerrja apo kontrolli
6 i provave të tilla, siç janë deklarata, dokumente, fotografi
7 apo sende të trupëzuara, që janë materiale -- me rëndësi
8 materiale për Mbrojtjen, duhet që të nxirren pa asnjë vonesë.

9 Gjithashtu u kujtoj palëve që sa i takon materialitetit të
10 informacionit, siç pretendohet nga Mbrojtja, duhet që t'i japin
11 parashtrimet e tyre menjëherë Gjykatësit të Procedurës
12 Paraprake.

13 Unë, pra, e përmend edhe këtu që Prokuroria ka përmendur
14 19 shkurtin 2021, si afat të vetëvendosur prej tyre lidhur me
15 nxjerrjen e këtyre materialeve. Dëshiroj që Prokuroria të
16 shprehet sa i takon afërsisë së përafërt dhe llojit të këtyre
17 materialeve, redaktimet e nevojshme dhe hollësi të tjera.

18 Z. PACE: [Përkthim] Për shkak të faktit që rishikimi vijon
19 dhe jemi në një fazë të hershme, më duhet të them që çdo gjë
20 tani është, pra, është e përkohshme. Por më duhet të them që
21 kemi grumbulluar shumë prova audiovizuale, të cilat janë
22 përfshirë dhe janë shoqëruar gjithashtu edhe nga transkripte
23 dhe përkthime, ndërkohë që presim që të kemi më tepër
24 informacione të kësaj natyre sa i takon llojit.

25 Ndërkohë që sa i takon sasisë, nuk mendoj se jam në

1 gjendje që të jap një shifër tani, sepse nuk varet vetëm nga
2 ajo çfarë ne po rishikojmë në kuadrin e rregullës 102(3), por
3 siç e thashë disa herë gjatë takimit të sotëm, nuk pres që të
4 ketë shumë materiale të cilat do të nxirren nën këtë pikë.

5 Sa i takon redaktimeve, ne nuk kemi bërë, nuk kemi kërkuar
6 redaktime deri tani, ndërkohë që çështje ose zëra të cilat ne i
7 kemi marrë nga burime publike, si p.sh., video e të tjera,
8 atëherë për to nuk është e nevojshme që të bëhen redaktime. Por
9 nga ana tjetër, në qoftë se ka deklarime të dëshmitarëve të
10 cilat vlerësohen se duhet t'i nënshtrohen procesit të
11 redaktimit nga Prokuroria, atëherë do ta bëjmë këtë gjë dhe do
12 t'ju njoftojmë sipas rastit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees, a keni ndonjë gjë
14 për të shtuar për këtë kategori?

15 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo, nuk kam gjë
16 për të shtuar. Faleminderit i nderuar Gjykatës.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti avokat.

18 Z. Cadman?

19 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo, nuk kam
20 asgjë as unë për të shtuar.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Tani le të kalojmë te pika e radhës që ka të bëjë me
23 provat shfajësuese. Do të doja t'i kujtoja Prokurorit të
24 Posaçëm që duhet që t'i zbulojë, t'i nxjerrë Mbrojtjes prova të
25 cilat janë shfajësuese, pra, në momentin që ata -- këto prova

1 janë në dispozicion të ZPS-së, dhe që mund të sugjerojnë në
2 mënyrë të arsyeshme pafajësinë e të akuzuarit ose mund të
3 lehtësojnë fajësinë e të akuzuarit, apo mund të kenë ndikim mbi
4 besueshmërinë dhe kredibilitetin e provave të ZPS-së. Nxjerrja
5 e provave shfajësuese është një detyrim i vazhdueshëm në varësi
6 të masave mbrojtëse sipas nevojës.

7 Mbaj shënim parashtrimet e ZPS-së që një pjesë e
8 materialit shfajësues është nxjerrë në përputhje me rregullën
9 102(1) (a), dhe e kuptoj që një segment i mëtejshëm i këtij
10 materiali është nxjerrë më 6 janar 2021. E ftoj ZPS-së që të na
11 thotë se cila është sasia dhe lloji i materialit shfajësues që
12 ka në posedim, kontroll, ose që është në dijeni të këtij lloji
13 materiali, dhe po ashtu do të doja t'i kërkoja që të na thotë
14 lidhur me redaktimet apo çështje të tjera që dëshiron që të
15 nxjerrë ZPS-ja.

16 Z. PACE: [Përkthim] Sa për të qartësuar, i nderuar z.
17 Gjykatës, pra, nxjerrja e dokumenteve, pra, 114 dokumenteve që
18 ne kemi bërë herën e fundit, kanë të bëjmë me pikën 126 [siç u
19 përkthye], ndërkohë që të hënën kemi nxjerrë materiale të cilat
20 kanë të bëjnë me rregullën 103. Bëhet fjalë për 67 materiale.
21 Megjithatë, paketa e parë, pra, materialet mbështetëse të
22 aktakuzës përfshijnë 62 materiale.

23 Jemi në dijeni të detyrimeve që rrjedhin nga ky rregull
24 dhe pa diskutim që po vijojmë me analizën tonë. Presim që
25 nxjerrja e 67 dokumenteve nën rregullën 103, është pjesa

1 kryesore, ose pjesa dërmuese e nxjerrjes që ne do të bëjmë mbi
2 mbështetjen e këtij rregulli. Dhe do të jemi në pozicion që të
3 japim më shumë informacion pas një jave ose dy. Megjithatë, më
4 lejoni të theksoj edhe njëherë, që nuk presim që zbulimet të
5 jenë voluminoze.

6 Sa i takon redaktimeve, nuk janë kërkuar redaktime deri
7 tani. Nuk jam i sigurt në qoftë se redaktime do të kërkohen për
8 materiale të tjera të cilat janë në posedim të Prokurorit të
9 Specializuar. Por në qoftë se ndodh kështu, do t'ju njoftojmë
10 dhe do të bëjmë kërkesat përkatëse.

11 Për materiale të cilat nuk i kemi ende në posedim, do të
12 spekulonim në qoftë se do të thoshim ndonjë gjë lidhur me këtë
13 gjë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

15 Tani do të doja t'i jepja fjalën Mbrojtjes.

16 Z. Rees, fjala për ju.

17 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë
18 për të shtuar për momentin.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

20 Z. Cadman.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] As unë nuk kam
22 asgjë për të shtuar.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Tani le të vijojmë më tej me materialet e mbrojtura, që
25 parashikohen nën rregullën 107. Marrë parasysh që ZPS-ja

1 parashikon një sasi të kufizuar të materialit që parashikohet
2 nën rregullën 107, edhe mbase ky informacion bie nën fushën e
3 rregullës 102(3). Do të doja t'i kërkoja ZPS-së që të na thotë
4 se cila është sasia apo lloji i materialit që ka ende nevojë
5 për të kaluar procedurat e nevojshme para sesa t'i jepet
6 Mbrojtjes, dhe të na thotë se cilat janë hapat të cilat
7 parashikohen në të ardhmen e afërt, edhe çfarë parashikon ZPS-
8 ja sa i takon heqjes plotësisht ose pjesërisht të detyrimit të
9 saj që bie nën parashikim e rregullës 102 dhe/ose 103 të
10 Rregullave të Procedurës, dhe në qoftë se do të jenë të
11 nevojshme redaktimet apo jo.

12 Z. Prokuror, fjala për ju.

13 Z. PACE: [Përkthim] Sa i takon llojit të materialit,
14 dokumentacioni është -- materiali është dokumentacion, e kemi
15 identifikuar deri tani. D.m.th., mbase mund të ketë edhe
16 informacione të tjera, por megjithatë d.m.th., në qoftë se kemi
17 lloje të tjera informacioni mbi materialin që do të nxirret, do
18 t'ju bëjmë atë në dijeni.

19 Ne jemi në proces e sipër të këtij -- të kësaj pune dhe do
20 të sigurohemi që të japim përgjigjet e nevojshme, por kjo punë
21 e jona varet edhe nga palët e tjera, nga palët e jashtme.
22 Megjithatë, në qoftë se nuk jemi në gjendje që të përmbushim
23 afatin kohor, do t'ju njoftojmë në kohën e duhur.

24 Sa i takon kërkesës për detyrimin, pra, nuk e di, nuk mund
25 të them ndonjë gjë lidhur me këtë.

1 Por sa i takon redaktimeve, sërish, lidhur me redaktimet,
2 më duhet të them që varet nga komunikimi me palë të tjera të
3 jashtme, dhe do të doja të thosha që analizimi i këtij
4 informacioni është në proces e sipër.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbrojtja, a ka ndonjë gjë
6 për të shtuar sa i takon kategorisë -- kësaj kategorie
7 materialesh? Pra, kategorisë së materialeve që parashikohet në
8 rregullën 107?

9 Z. Rees.

10 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

14 Tani le të kalojmë më tej me procedurën për nxjerrjen e
15 informacionit.

16 Në parashtrimet e veta ZPS-ja indikon që mbështet
17 miratimin e regjimit të ngjashëm si me çështjen *Mustafa*. Do të
18 doja të ftoja ZPS-në që të japë detaje të mëtejshme për këtë
19 çështje, si dhe të gjitha palët e tjera për të komentuar për
20 rregullën 109(c) të propozuar nga ZPS-ja.

21 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar z. Gjykatës, nuk kam asgjë
22 për të shtuar lidhur me këtë pikë. Duket sikur tabela që i kemi
23 dhënë Mbrojtjes është pritur mirë nga ata, dhe sigurisht që
24 jemi të gatshëm që të angazhohemi në diskutime të tjera të
25 vazhdueshme. Për momentin nuk kam asgjë tjetër për të shtuar

1 lidhur me këtë pikë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Rees, fjala për ju.

4 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam gjë për
5 të shtuar. Faleminderit.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Neve e
8 përmendëm në fakt këtë, pozicionin tonë sa i takon pjesës së
9 tabelës me informacion që na është vënë në dispozicion, edhe
10 gjithashtu edhe preferencën që kemi për regjimin që duhet të
11 ndiqet. Nuk kam gjë tjetër për të shtuar.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror, sa për të
13 qartësuar. Ju keni ndarë të njëjtin model tabele si në çështjen
14 *Mustafa*. Është kështu apo jo?

15 Z. PACE: [Përkthim] Po. Është identike si model. Mendoj që
16 ndoshta vetëm një kolonë është ndryshe nga çështja kundër z.
17 *Mustafa*, por përmbajtja është e njëjtë, dhe z. Gjykatës, do ta
18 shikoni në momentin që ne të biem dakord.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le të kalojmë në pikën
20 e fundit që kemi në rendin e ditës për sot, regjimi i
21 redaktimit.

22 Pra, në miratimin e regjimit të redaktimit është e
23 nevojshme që të sigurojmë efikasitetin ndërmjet procesit të
24 nxjerrjes, ndërkohë që arrijmë një baraspeshë ndërmjet detyrës
25 për të mbrojtur interesat e viktimave dhe dëshmitarëve dhe

1 respektimin e të drejtave të të akuzuarve.

2 Në parashtrime, ZPS-ja kërkon që Gjyqtari i Seancës
3 Paraprake të miratojë regjimin e redaktimit që është aplikuar
4 në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, dhe në përputhje me këtë
5 regjim, në mënyrë që të shmangen rinxjerrje të të njëjtave
6 prova, pala zbuluese ose nxjerrëse e informacionit nuk është e
7 nevojshme që të nxjerrë materiale përkatëse në të njëjtën kohë
8 me kërkesën për redaktime jo standarde.

9 Do të doja që t'i kërkoja ZPS-së që të shpreh sepse
10 preferon regjimin që zbatohet në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*,
11 krahasimisht me regjimin në çështjen *Mustafa*, duke pasur
12 parasysh që sasia e redaktimeve është shumë herë më e madhe për
13 çështjen *Thaçi*.

14 Do të doja që të thosha gjithashtu, që sipas modelit të
15 regjimit të çështjes *Thaçi dhe të tjerë*, kemi një afat kohor
16 10-ditor për parashtrime, krahasimisht me 5 ditët në
17 dispozicion të regjimit që aplikohet në çështjes kundër
18 Mustafës.

19 Z. Prokuror.

20 Z. PACE: [Përkthim] Arsyëja kryesore sepse ne kemi
21 shprehur preferencën tonë për çështjen *Thaçi*, për regjimin për
22 çështjen *Thaçi*, është arsye të cilën juve e përmendët në
23 ndërhyrjen tuaj, d.m.th., që të mos bëhet rinxjerrja e
24 informacionit i cili është nxjerrë më parë. Është e drejtë ajo
25 që thatë juve, që sasia e informacionit që nxirret për çështjen

1 në fjalë është shumë herë më e vogël sesa në çështjen kundër z.
2 Thaçi, dhe prandaj ne kemi zgjedhur regjimin në fjalë.

3 Sa i takon afateve kohore, neve preferojmë që të kemi
4 afatin kohor prej 10 ditësh, megjithatë në qoftë se ju mendoni
5 që afati kohor prej 5 ditësh është më i përshtatshëm për këtë
6 çështje, nuk është se do e kundërshtojmë këtë gjë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Tani Mbrojtja. Z. Rees.

9 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
10 Gjykatës, në urdhrin fillestar që ju keni bërë në përgatitje të
11 kësaj seance, në urdhër thuhet që të shikohet regjimi i cili ka
12 të bëjë me çështjen *Mustafa*. Ne nuk është se e kemi me
13 shqetësim, nuk kemi ndonjë shqetësim sa i takon kësaj çështje,
14 apo nuk është se kemi një kundërshtim të këtij regjimi për t'u
15 aplikuar në rastin, në çështjen tonë. Megjithatë, më duhet të
16 them që në qoftë se ka çështje që do të ngrihen, ne të kemi
17 mundësi që këto çështje t'i ngremë në momentin e duhur.

18 Ndërkohë që sa i takon propozimit të ZPS-së --
19 kundërpropozimit nga ZPS-ja, ne ende nuk e kuptojmë dot në
20 qoftë se ZPS-ja i është përgjigjur pyetjes. Nuk më duket sikur
21 u dha ndonjë justifikim real sa i takon kësaj çështjeje, pra,
22 sa i takon kuadrit të kësaj çështjeje. Pra, ne mendojmë që
23 procedura e cila ndiqet në çështjen *Mustafa*, duhet të ndiqet
24 edhe në çështjen në fjalë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

1 Z. Cadman.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe unë kam
3 të njëjtin kundërshtim. Juve na drejtuat që të shqyrtojmë në
4 fakt, apo t'i drejtoheshim regjimit të redaktimit në çështjen
5 *Mustafa*, dhe këtë gjë e kemi bërë. Ne nuk e kuptojmë arsyen
6 sepse Prokuroria preferon që të përdoret regjimi në çështjen
7 *Thaçi*.

8 Ne jemi të kënaqur me regjimin e redaktimit që zbatohet në
9 çështjen *Mustafa*, kështu që nuk e kuptojmë dot kundërshtimin.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror, përpara sesa të
11 merrni fjalën, atëherë, do të doja të thosha që dy regjimet
12 janë shumë të ngjashëm, por dy dallimet kryesore janë ato të
13 cilat unë i thashë pak më sipër kur prezantova këtë temë.
14 D.m.th., njëra ka të bëjë me afatin kohor, d.m.th., në çështjen
15 -- në regjimin e çështjes *Thaçi* kemi 10 ditë në dispozicion. Në
16 çështjen tjetër, në regjimin tjetër kemi 5 ditë. Dhe ndryshimi
17 tjetër është që nuk bëhet dy nxjerrje të informacionit,
18 d.m.th., kërkohet vetëm një herë dhe nxirret vetëm një herë
19 informacioni. Pjesa tjetër është tërësisht e ngjashme, e
20 njëjtë.

21 Z. Prokuror.

22 Z. PACE: [Përkthim] Po, jam plotësisht dakord me atë çfarë
23 thatë. Të njëjtën gjë do të thosha dhe unë në fakt. Pra, në një
24 prej shënimeve që kemi bërë në parashtrimin tonë, pra, kemi
25 thënë që ne nuk është se e kundërshtojmë regjimin e çështjes

1 *Mustafa*. Arsyen e dhamë sepse e preferojmë regjimin e çështjes
2 *Thaçi*.

3 Megjithatë nuk është ndonjë problem shumë i madh për neve.
4 Në qoftë se Gjykatësi vendos që çështja *Mustafa* dhe regjimi i
5 kësaj çështjeje është më i zbatueshëm për këtë çështje, për
6 neve nuk ka asnjë pikë problemi.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.
8 Z. Rees.

9 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë
10 për të shtuar.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.
12 Z. Cadman.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam
14 kundërshtim.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.
16 Përpara se të vijojmë më tej me konferencën e procesit

17 gjyqësor në të ardhmen, do të doja t'i jepja fjalën palëve në
18 qoftë se kanë ndonjë shqetësim për të ngritur.

19 Dua t'u kujtoj palëve që të na njoftojnë në qoftë se
20 ndonjë prej parashtresave të tyre do të çojë në zbulimin e
21 informacionit konfidencial.

22 Z. Prokuror, fjala për ju.

23 Z. PACE: [Përkthim] Po. Kam dy çështje z. Gjykatës.

24 Së pari, do të doja t'i përgjigjesha parashtresave --
25 parashtrimeve të bëra nga avokati i z. Gucati. Në parashtrimet

1 me shkrim, Mbrojtja duket sikur nënkupton që ZPS-ja në njëfarë
2 mënyre mund të jetë e lidhur me individë të panjohur të cilët
3 kanë dhënë dhe kanë dërguar dokumentacionin te Shoqata e
4 Veteranëve të Luftës, dhe ato po ashtu citojnë një vendim të
5 Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

6 Do të doja të thosha që neve e kundërshtojmë tërësisht
7 këtë implikim të pabazuar. Dhe sa i takon, le të themi,
8 aktpadisë, në të është e qartë që është i akuzuari i cili ka
9 kryer krim dhe çdo përpjekje për të zhvendosur vëmendjen është
10 e dështuar.

11 Sa i takon përshpejtimin të proceseve gjyqësore, në qoftë
12 se do të ndiqni procesin i cili parashikohet në rregullën 72,
13 Prokuroria nuk do ta kundërshtojë një vendim të tillë prej
14 jush.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Tani fjalën e ka Mbrojtja.

17 Z. Rees, ju lutem, në qoftë se mund të shpreheni si lidhur
18 me atë se çfarë tha Prokuroria, dhe në qoftë se ka ndonjë
19 çështje tjetër që ju do të donit të ngrini, ju lutem flisni
20 tani.

21 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Thjesht do të
22 përsëris diçka që e kemi shkruar në parashkrimin me shkrim dhe
23 që e kemi përsëritur dhe më parë.

24 Neve i kemi kërkuar, pra, ZPS-së që të provojë në mënyrë
25 strikte dokumentacionin që është i përfshirë në paketën 1, 2

1 dhe 3. Dhe po ashtu i kemi kërkuar ZPS-së që të dëshmojë
2 origjinën dhe epërsinë e dokumentacionit, dhe mënyrën sesi
3 dokumentacioni ka përfunduar në Shoqatën e Veteranëve të
4 Luftës.

5 Dhe mënyra sesi është shprehur Prokuroria, pra, unë e
6 kuptoj që ata nuk kanë ndonjë problem që ta demonstrojnë këtë
7 gjë, dhe ne do të kontrollojmë atë çfarë është deklaruar nga
8 SPO-ja [siç u përkthye]. Kështu që mezi pres që të marr këtë
9 informacion në mënyrë që të mund ta analizojmë atë, dhe në
10 mënyrë që të mund të arrijmë në përfundimet përkatëse tonat.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

12 Z. Cadman, ju lutem.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

14 Atëherë, shkurtimisht do të doja që t'i referohem
15 rregullës 72. Kjo është diçka që mbase do ta rizekim sërish
16 edhe në të ardhmen. Nuk është një çështje e cila kërkon
17 patjetër trajtim tani, megjithatë kjo është diçka që do të
18 duhet t'i rikthehem sërish në momentin e duhur.

19 Përveç kësaj, nuk është se kam asgjë tjetër për të shtuar.
20 Gjithçka është dhënë në parashtrimet tona me shkrim.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

22 Z. Prokuror, nuk e di në qoftë se keni ndonjë gjë për të
23 shtuar? Ju lutem, sa më shkurt.

24 Z. PACE: [Përkthim] Po, shumë shkurt, në përgjigje të
25 Mbrojtjes së z. Gucati. Dua të them që ZPS-ja është e angazhuar

1 për të respektuar barrën që është parashikuar në ligj, edhe për
2 të vërtetuar akuzën që është ngritur kundër z. Gucati.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

4 Tani do të doja që t'i kërkoja palëve që të më jepnin
5 mendimin e tyre sa i takon konferencës së ardhshme. Pra, siç u
6 tha nga ZPS-ja, do të bëhet nxjerrja e dokumenteve të
7 parashikuara nën rregullën 102(1)(b) dhe rregullën 103 [siç u
8 përkthye] deri më 19 shkurt, dhe sugjeroj që konferenca e
9 radhës të organizohet në periudhën nga 24 deri në 26 shkurt.

10 Pra, do të doja të dija sesa jeni të disponueshëm për këtë
11 periudhë kohore?

12 Nga ana tjetër, në qoftë se avokatët duan të marrin
13 parasysh -- të marrin pjesë në seancë përmes videolinkut, do të
14 duhet që të bëhen njoftimet 24 orë përpara datës së caktuar, në
15 mënyrë që të mund të bëjnë organizimet përkatëse.

16 Z. Prokuror.

17 Z. PACE: [Përkthim] Jemi në dispozicion në çdo datë që do
18 të përcaktohet nga ju.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le të vazhdojmë me
20 Mbrojtjen.

21 Z. Rees, ju lutem.

22 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ne nuk i kemi
23 marrë këto data më parë, dhe për momentin secila prej këtyre
24 datave është pak e vështirë për mua. Nuk e di sesa është në
25 gjendje z. Bouden që t'i ndjekë këto -- të ndjekë seancat

1 gjyqësore në këto data, pra, bashkëmbrojtësi.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees, nëse do t'ju duhen
3 -- mund të na duhet disa ditë për ta vendosur datën e saktë,
4 por ideja e përgjithshme është që në këtë Konferencë për
5 Ecurinë e Çështjes, pasi të keni marrë të gjithë materialin,
6 ose dy ditë -- disa ditë pas saj, a është kjo e përshtatshme
7 për ju si datë?

8 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Sigurisht ne
9 duam që të kemi edhe një Konferencë tjetër për Ecurinë e
10 Çështjes.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk keni mikrofon z. Rees.

12 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ne sigurisht
13 duam që të kemi një Konferencë tjetër për Ecurinë e Çështjes në
14 javën pas 19 shkurtit. Sesa do të jemi në gjendje ne ta
15 ndihmojmë Gjykatën për sa i përket këtyre çështjeve, do të
16 varet nga materiali që do të marrim. Për mua do të ishte më e
17 përshtatshme që të bëhet konferenca rreth asaj date, ose një
18 javë më vonë, d.m.th., në fund të asaj jave, që i bie diku 5
19 marsi.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe unë e kam
22 të përshtatshme datën e mëvonshme që e përmendi z. Rees, sepse
23 do të na duhen disa ditë pasi të nxirret materiali që të shohim
24 se cili është pozicioni jonë. Pra, edhe ne si -- edhe unë si
25 mbrojtës i z. Haradinaj, e kemi më të përshtatshme një datë në

1 mars sesa në shkurt.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

3 Në qoftë se s'ka askush gjë tjetër për të shtuar, me kaq
4 mbyllet seanca e sotme.

5 Falënderoj palët dhe Zyrën Administrative për pjesëmarrjen
6 e tyre, dhe gjithashtu përkthyesit, stenografët dhe të gjithë
7 teknikët.

8 Seanca mbyllet.

9 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundon
10 në orën 16.02

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25